

**INSTITUTI I KURRIKULAVE DHE STANDARDEVE**

**LËNDA: GJEOGRAFIA E MAQEDONISË**

**KLASA VIII**

**ARSIMI I MESËM I ULËT PËR  
PAKICAT MAQEDONASE**

**TIRANË, 2006**

## **I. NJOHURI TË PËRGJITHSHME**

Lënda gjeografia e Maqedonisë zhvillohet për herë të parë tek nxënësit e klasës së 8-të të minoritetit maqedonas të shkollës 9 – vjeçare Liqenas, Goricë e Vogël (Korçë) në vitin shkollor 2007 – 2008.

Ajo do të zhvillohet 1 orë në javë ose 35 orë gjatë gjithë vitit shkollor.

Nxënësit pasi kanë studiuar më parë dhe gjeografinë e Shqipërisë të kenë mundësi të krahasojnë veçoritë natyrore të popullsisë midis dy vendeve fqinjë, të çmojnë pasuritë të përbashkëta natyrore e njerëzore, të mbajnë qëndrim ndaj fenomeneve keqbërëse dhe ndotjeve të ndryshme, të japin kontributin e tyre në propagandimin e dijeve të reja, atje ku jetojnë dhe mësojnë.

Nxënësit nëpërmjet këtij programi do të njihen më afër me rajonin evropian, në këtë rast, Prespa që shtrihet në tre shtetet fqinjë dhe perspektivën e tij.

Programi i kësaj lënde të re është parë që të jetë tërheqës dhe i kapshëm nga nxënësit, është çliruar nga hollësitat, jemi duke u përpjekur që t'i përshtatemi moshës së nxënësve.

Objektivat e përgjithshme dhe ato kryesore të kësaj disipline shkollore përfaqësojnë standarde shtetërore të formimit gjeografik të nxënësve, të cilat janë të detyrueshme për tu realizuar. Këto objektiva do ta orientojnë mësuesin në përcaktimin e objektivave specifike të çdo teme.

## **II. SYNIMET TË PËRGJITHSHME TË LËNDËS**

a) Objekti i studimit të lëndës.

Gjeografia e Maqedonisë klasa e 8-të ka për objekt studimi në përshtatje me moshën e nxënësit natyrën, popullsinë, ekonominë e Maqedonisë, lidhjet ndërmjet natyrës dhe zhvillimit të organizimit hapësinor të veprimtarisë jetësore e prodhuese të popullsisë maqedonase.

b) Në përfundim të studimit të lëndës nxënësi duhet:

1. Të nderojnë dhe të jenë krenarë për Shqipërinë, vendin ku jetojnë, dhe për Maqedoninë fqinje si shtete mëmë.
2. Të jenë tolerantë të pranojnë ndryshueshmërinë dhe të jenë urë miqësimi midis dy popujve fqinje.
3. Të jenë të gatshëm për të bashkëjetuar dhe bashkëvepruar me këtë popull fqinjë edhe më gjerë.
4. Të njohin dukuritë kryesore gjeografike që shfaqen në territorin e Maqedonisë dhe në rajonet e veçanta të saj.
5. Të njohin hartën e Maqedonisë dhe hartën memece të saj, të bëjnë të “flasë” pasi ta mbushë.
6. Të njohë rolin dhe ndikimin përcaktues të veprimtarisë jetësore e prodhuese të shoqërisë maqedonase mbi natyrën.
7. Të njohin projektin e fundit për Evropë- rajonin Prespa “TRABOREMA”.
8. Të njohin konceptet për menaxhimin e ujërave ndërkufitare dhe zhvillimin e qëndrueshëm social–ekonomik në rajonin kufitar midis Shqipërisë, Maqedonisë dhe Greqisë.

9. Të jenë të aftë të udhëtojnë në hartën fizike dhe politike të Maqedonisë si pjesë e Ballkanit.

### III. SYNIMET KRYESORE TË LËNDËS

Nxënësit duhen të jenë në gjendje:

1. Të shpjegojnë arsyet e copëtimit të Maqedonisë në periudha të ndryshme historike dhe statuti i tyre aktual politik .
2. Të njohin pasuritë natyrore dhe shkallën e shfrytëzimit të tyre.
3. Të tregojnë shtrirjen hapësinore të Maqedonisë, kufijtë dhe madhësia e tyre.
4. Të argumentojnë shkaqet e ndotjes së mjedisit në Maqedoni dhe në liqenin e Prespës.
5. Të përshkruajnë veçoritë gjeografike të rajoneve.
6. Të njohin veçoritë strukturore dhe shpërndarëse hapësinore të popullsisë, tendenca e zhvendosje të kësaj popullsie.
7. Të përshkruaj karakteristikat e zhvillimit ekonomik dhe të organizimit hapësinor të ekonomisë, gjendja aktuale dhe prirjet e së ardhmes.
8. Të hartojnë përshkrime gjeografike për peizazhe të ndryshme fizike dhe humane.
9. Të paraqesin në mënyrë grafike dukuritë e ndryshme gjeografike.
10. Të përshkruajnë vendndodhjen dhe shpërndarjen hapësinore të vendbanimeve.
11. Te nxjerrin përfundime rrjedhoja nga aktiviteti njerëzor në zonën e Prespës ku jetojnë dhe vet nxënësit.
12. Te lexojnë hartat e ndryshme të Maqedonisë dhe ti përdorin si burime për fitimin e njohurive të reja.

### IV. LINJAT DHE NËNLINJAT E PËRMBAJTJES.

|                 |        |
|-----------------|--------|
| Njohuri të reja | 26 ore |
| Përsëritje      | 2 ore  |
| Punë praktike   | 2 ore  |
| Ore të lira     | 5 ore  |
| Gjithsej        | 35 ore |

| Nr. | Kapitujt   | Orët |
|-----|--|------|
| 1   | Maqedonia ( pozita gjeografike, kufijtë, sipërfaqja)     | 2    |
| 2   | Karakteristikat natyrore – gjeografike të Maqedonisë     | 11   |
| 2.1 | Relievi i Republikës së Maqedonisë                       | 3    |
| 2.2 | Klima e Republikës së Maqedonisë                         | 3    |
| 2.3 | Hidrografia e Republikës së Maqedonisë                   | 3    |
| 2.4 | Evolucioni gjeologjik i truallit                         | 1    |
| 2.5 | Bota bimore e shtazore e Republikës së Maqedonisë        | 1    |
| 3   | Karakteristikat e popullsisë në Republikës së Maqedonisë | 5    |
| 3.1 | Popullsia në Republikës së Maqedonisë                    | 3    |
| 3.2 | Qendrat e banuara në Republikës së Maqedonisë            | 2    |
| 4.  | Karakteristikat e ekonomisë në Republikës së Maqedonisë  | 8    |
| 4.1 | Ekonomia dhe degët e ekonomisë. Bujqësia                 | 2    |
| 4.2 | Blegtoria në Republikës së Maqedonisë                    | 1    |

|     |   |   |
|-----|---|---|
| 4.3 | Pyjet dhe peshkimi ne Republikës se Maqedonisë                          | 1 |
| 4.4 | Burimet energjetike dhe pasuritë e metaleve ne Republikës se Maqedonisë | 1 |
| 4.5 | Industria ne Republikës se Maqedonisë                                   | 1 |
| 4.6 | Transporti ne Republikës se Maqedonisë                                  | 1 |
| 4.7 | Tregtia dhe turizmi ne Republikës se Maqedonisë                         | 1 |

## V. AFTËSITË KRYESORE SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

Në kapitullin e parë, Maqedonia, nxënësit do të njihen me pozitën gjeografike të këtij shteti në hartën e Ballkanit, Evropës dhe Botës si ka ndryshuar kufijtë e saj deri me sot, sipërfaqja dhe shtetet që kufizohet. Në kapitullin e veçorive natyrore nxënësit duhen të kuptojnë se kufijtë politikë nuk ndikojnë në veçoritë natyrore midis vendeve fqinjë. Ata midis tyre ngjajnë, kanë tipare të përbashkëta.

Për relievin duhen të dinë; njësitë fiziko – gjeografike të Maqedonisë të ndarë sipas formave të relievit, shtrirjen e tyre, si shfrytëzohen dhe mbrohen ato.

Nxënësit të kuptojnë klimën e veçante të Maqedonisë në qendër të Ballkanit pa dalje në dete, veçoritë klimatike në aspektin vertikal. Të kuptojnë pasurinë hidro-grafike, lumenjtë, liqenet, pellgjet ku ato derdhen, shfrytëzimi i tyre, rruajtja nga ndotja.

Të kuptojnë shumë-llojshmërinë e pasur bimore e shtazore, ruajtja me fanatizëm dhe me kulturë të saj. Ajo është e virgjër siç e ka krijuar natyra.

Të kuptojnë veçoritë e popullsisë së Maqedonisë me gjithë elementet e saj në kohën e sotme, qendrat e banimit qytet – fshat, shpërndarje dhe roli i tyre.

Nxënësit të njihen me veçoritë e ekonomisë së Maqedonisë, të kuptojnë se bujqësia është dega kryesore e saj dhe prodhimet bujqësore shërbejnë si lëndë e parë për industrinë e lehtë dhe për eksport.

Të kuptojnë se Maqedonia ka një infrastrukturë të mirë të trashëguar nga ish Jugosllavia, ku shumë probleme janë zgjidhur njëherë e përgjithmonë.

Nxënësit duhet të kuptojnë se sot Maqedonia është kandidatë për anëtare në Bashkimin Evropian.

## VI. METODOLOGJIA E ZBATIMIT TE PROGRAMIT

Gjeografia e Maqedonisë klasa e 8 krijon mundësi të reja për zbatimin e metodave, teknikave dhe strategjive gjatë procesit mësimor – edukativ.

Në këtë mes rrol të madh dhe të pa zëvendësueshm luan shkalla e kualifikimit, pasioni i mësuesit për lëndën, ndërthurja e formave tradicionale më të rejtat, baza materialo – didaktike.

Përzgjedhja e metodës mësimore është në kompetencë të mësuesit të lëndës. Ajo bëhet në përshtatje e veçoritë e përmbajtjes së temave mësimore, me bazën didaktike, me nivelin e formimit gjeografik të nxënësve etj.

Metodat e teknikat e mësimdhënies janë të larmishme. Gjatë një ore mësimore mësuesi mund të përdor disa teknika dhe metoda mësimore të kombinuara me njëra – tjetra në mënyrë që edhe rezultatet në fund të procesit mësimor të jenë të kënaqshme.

Metodat bazë mbeten shpjegimi dhe biseda të gërshetuara me përshkrimin dhe demonstrimin si në aspekte të veçanta dhe të domosdoshme në konkretizimin e orës së gjeografisë.

Shpjegimi i përsosur nga mësuesi do forconte dhe nguliste qartë dhe saktë përmbajtjen e materialit lëndor, te zgjeronte horizontin gjeografik te nxënësit.

Metoda e bisedës mund të zgjerohet me atë që ne e quajmë “ stuhi mendimesh”, mësimi zbulues, etj.

Në të gjitha rastet zbatimi i metodave duhet të shoqërohet me përdorimin e bazës materiale didaktike ku vend kryesor të zënë hartat e ndryshme.

## **VII. ZBATIMI I KURRIKULËS SE LIRË**

Ky aspekt ka për qëllim t'u lërë hapësirë iniciativës dhe krijimtarisë së shkollës dhe mësuesit për të përmbushur sa më mirë nevojat dhe interesat e nxënësve në përputhje me objektivat e programit dhe kushteve ku jetojnë dhe mësojnë nxënësit.

Statusi i kurrikulës është i dyfishtë, i detyrueshëm dhe i ndryshueshëm.

Është i detyrueshëm sepse duhet zhvilluar deri në fund të vitit shkollor bashkë me gjithë programin, dhe i ndryshueshëm sepse shpërndarja gjatë vitit dhe mbushja me material mësimor është në kompetencë të mësuesit të lëndës në bashkëpunim me drejtorinë e shkollës.

Mësuesi duhet të përgatit dhe përzgjedh material mësimor. Ky duhet ti shërbejë realizimit të objektivave të programit dhe synimeve të përgjithshme për një përvetësim më të mirë të tij.

Organizimi i konkurseve, bisedave të hapura, referateve të shkurtra, takime me gjeografë, studime për gjeografinë e Prespës, shikimi i kasetave që mund të gjenden për natyrën, urbanistiken, turizmit të Maqedonisë.

Që të ritet efekti i kurrikulës së shkollës mund të bashkëpunohet edhe me mësuesit të lëndëve të tjera si të historisë, biologjisë etj. duke programuar dhe zhvilluar veprimtari të përbashkëta që mundësojnë realizimin e lidhjeve ndër-lëndore.

Këto sugjerime mund të realizohen, ndaj kërkohet aftësi krijuese dhe përgjegjësi profesionale nga vet mësuesi.

## **VIII. LIDHJA NDËRLËNDORE**

Gjeografia e Maqedonisë në klasën e 8 të shkollës 9 – vjeçare nuk do të mund të kuptohej dhe konceptohej në qoftë se nxënësit nuk do të kishin marrë njohuri ndihmëse dhe paralele për këtë shtet në lëndët e tjera.

Vet struktura e procesit mësimor tregon se nxënësi merr njohuri indirekte për gjeografinë e Maqedonisë.

Nxënësi merre njohuri nga Gjeografia e klasave V,VI,VII, Historia e klasave V,VI,VII, Biologjia, Edukata shoqërore etj.

Për këtë dhe teksti i Gjeografisë se Maqedonisë që do të hartohet nuk do ti përsërisë këto probleme që nxënësi i ka mësuar nga lëndet e tjera.

Mbi themelin e ngritur nga këto njohuri, gjeografia e Maqedonisë do të mbush boshllëkun e krijuar prej vitesh në shume breza nxënësish.

## **IX. VLERËSIMI**

Vlerësimi është një drejtim i rëndësishëm në procesin mësimor – edukativ. Ai ka të bëjë me mënyrat dhe teknikat që përdoren për përparimin e nxënësve për tema të veçanta, grup temash ose për përfundimet e tyre mësimore në mbyllje të semestrit ose të vitit shkollor.

Vlerësimi ka për qëllim:

Të siguroj informacione identifikuese për arritjet e nxënësve.

Të përcaktojë përparimin e nxënësve.

Të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara.

Ti motivojë nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve qoftë ky sistematik (për çdo orë mësimi) periodik në përfundim të çdo kapitulli, semestral apo vjetor, mund të realizohet nëpërmjet teknikave të ndryshme, si me shkrim, me gojë, me veprimtari praktike, me punë praktike, me testim i punës me hartën, zgjidhjet e detyrave etj.

Gjatë zbatimit të testit sistemi i pikësimit zgjidhet nga vet mësuesi. Për vet përmbajtjen e programit e të lëndës, testet mund të zbatohen në tri llojet e tyre që iu përgjigjet qëllimeve të caktuara:

1. Test për të vlerësuar nivelin fillestar të nxënësve për gjeografinë e Maqedonisë.
2. Testim gjatë mësimdhënies me objektiv përparimin e nxënësve.
3. Testim në përfundim të mësimdhënies për të kontrolluar dhe vlerësuar përvetësimin e njohurive bazë të lëndës.